



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Procesverbal

Konsultimi fillestar publik për Projekt Dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale me qytetarë i mbajtur më 26/03/2024

Takimi filloi në orën 10:30, në sallën nr.52.

Takimin e hapi dhe e kryesoi **z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.**

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (rreth 9 - bashkëngjitur foto e pjesëmarrësve) dhe zyrtarë komunal.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi arsyen për mbajtjen e këtij debati publik.

Ashtu siç edhe jeni të informuar, në këtë takim si temë është paraparë:

➤ **Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale.**

Të nderuar të pranishëm prezentimi i draft Planit Rregullues të Hollësishëm është bërë me datën 22.03.2024, prandaj pa humbur kohë po fillojmë me pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e juaja.

Urdhëroni, fjala për ju.

z. Rifat Ferizi, përfaqësues ligjor i Xhemajl Arfit, theksoi;

-Në lidhje me disa prona në Zonën Kadastrale - Livadicë ka një aktgjykim i Gjykatës Komunale i cili nuk është ekzekutuar në kadastrin e Podujevës.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqaroi;

-Për këtë çështje nuk është kompetent dhe se një përgjigje të saktë do të mund ta merrnin nga Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

z. Rifat Ferizi, përfaqësues ligjor i Xhemajl Arfit, vazhdoi si në vijim;

- Ekzekutivi i vendimeve gjyqësore është duke zhvilluar procedura penale në Prokurorinë Thelore të Prishtinës, në procedurë administrative është ankimi vendimi i Qeverisë për këto parcela, për shpronësim në dhomë të posaçme të Gjykatës Supreme është ankimi çështja e të drejtës së përkthimit të pronave bartjes te Qeveria.

-Një hartë me koncepte kish qenë mirë me kriju!

Ndërpreje

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqarim parafolësit, theksoi;

- Përmes Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë më njoftuan se procedurat duhet t'i zhvillojë përmes gjykatës, pastaj gjykata jep vendimin për çdo gjë që është kontestuese.

z. Rifat Ferizi, përfaqësues ligjor i Xhemajl Arfit;

- Pronat janë të ndara në publike, private dhe ato të kontestuara, pronat tona janë të paraqitura si publike. Unë jam këtu për pasqyrim të gjendjes faktike jo të drejtë.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqaroi;

- Në diskutimin aktual mund të flasim për Planin Rregullues dhe se qytetarët mund të vazhdojnë me ankesat në lidhje me parcelat publike në organet kompetente, ndërsa theksoi se për këtë çështje do të duhej të merrnin pjesë në debatin publik i cili ishte për këtë arsye. Debat ky i cili ka qenë i shpallur në faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

z. Veli Hasani, shtoi;

- Tokat tona janë paraqitur si prona publike, askush nuk na ka informuar në lidhje me këtë plan dhe për planifikimin e këtyre ndërtimeve.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi;

- Nëse Komuna interesohet për këto prona atëherë do të bëhet shpronësimi i tyre dhe qytetarët do të paguhet për çdo m². Në asnjë pronë private nuk do të ndërhyjë Komuna pa filluar procesin e shpronësimit.

Takimi përfundoi në ora 11:15

Procesverbalin e mbajti,

Blerina Zeka



**Podujevë,
26/03/2024**





